

Arco & Iris

në Amerikën e Jugut



*Edashur lexuese, I dashur lexues,
Kjo është historia e udhëtimit të Arkos dhe Irisit
në Amerikën e Jugut.*

*Arko dhe Iris janë dy të rinj që kanë jetuar për
shumë vite në një kuti kursimi brenda një kase xhami
të vendosur në Muzeun e Kursimit në Torino, Itali.
Historia e Arkos dhe motrës së tij Irisit na fut në
botën e mrekullueshme të një koleksioni të përbërë prej rreth
1700 kutish kursimi, që i janë dhuruar muzeut nga
familja Tana, duke i kushtuar vëmendje të
veçantë shembujve që na njohin me vende të largëta e me
histori magjepsëse.*

*Udhëtimi i dy fëmijëve tanë të vegjël u jep mundësinë
prindërve që të kalojnë një mbrëmje argëtuese me fëmijët
e tyre, duke eksploruar ide të reja ose duke rimenduar disa
koncepte që qëndrojnë në thell të një mirëadministrimi të
parave, e që mund t'u mësohen fëmijëve që në moshë të
vogël në mënyrë krijuese dhe të këndshme.*

*Në faqen e fundit, gjithashtu për të ndihmuar prindërit
dhe fëmijët për të rikujtuar, ekziston një përmbledhje e
shkurtër në formën e një vjershe të thjeshtë.
Shpresojmë shumë që ndërsa lexoni, ju të merrni të
njëjtën kënaqësi që ne kemi provuar gjatë shkrimit të
këtij libri të vogël!*

Arko dhe Iris kishin mbetur në një kuti parash për një kohë shumë shumë të gjatë, të mbështetur e të bashkuar nga një ylber i bukur.

Ata do të kishin dashur të merrnin një aeroplan të fluturonin lart dhe të shikonin ylberin me të vërtetë, sepse ata mund ta shikonin atë vetëm me mendjet e tyre, duke imagjinuar!



Ata jetonin në Torino në një muze të kursimeve dhe në kutinë e qelqtë pranë tyre ishte një kuti e bukur parash në formë globi, me dy njerëz me pamje qesharake të ulur në një aeroplan!

Kush e di sa bukur duhet të ishte që të udhëtonin! Por duhej që të dilnin dhe të eksploronin botën! Do të kishin shumë aventura të reja dhe shikonin e vizitonin sa e sa vende të mrekullueshme...

Por si mund ta bënin realitet
Pëndrrën e tyre? Dukej e pamundur!
Ata nuk kishin qenë ndonjëherë as
jashtë Muzeut...

Ndaj vendosën të kërkonin një
këshillë nga një zonjë e mirë e
vogël e moshuar që ishte ulur
në kutinë pranë tyre.

«Të dashur Arko dhe Iris,
– u përgjigj ajo – unë jam
shumë plakë dhe unë
asnjëherë nuk kam dalë
nga ky vend, por ju
këshilloj që para së
gjithash, të mendoni me
kujdes se ku dëshironi
që të shkoni, pastaj
do t'ju duhet që të
kurseni paratë e
nevojshme që do t'ju
duhen, gjithashtu
hidhni një sy edhe në
arkën tuaj të kursimit
për të parë nëse ka
mbetur diçka... »



Ditët kalonin ngadalë, por pak nga pak Arko dhe
Iris mblodhën të gjitha paratë e harruara në
kutitë e tjera të kursimeve.



Një natë, pa e ditur se çfarë po ndodhte, nëse ishte një ëndërr apo një magji, ata u zgjuan dhe panë se ishin si njerëzit e vërtetë... prej mishi e gjaku!!! Ata nuk mund ta besonin dot!




Shpesh kishin menduar shumë gjatë së bashku se për ku mund të ishte udhëtimi i tyre i parë dhe, pas konsultimit me të gjithë atlaset dhe globet në koleksionin e muzeut, ata e kishin vendosur: do të shkonin në Amerikën e Jugut!

Si fillim, ata morën një valixhe të bukur ngjyrë kafe nga një tjetër vitrinë dhe vendosën brenda saj të gjitha paratë e kursyera për udhëtimin e tyre. Kishin mbledhur një shumë të mirë parash.

E moshuara kishte të drejtë: një qindarkë sot, një qindarkë nesër, kështu rriten kursimet... dhe kur t'ju duhen do të keni paratë e nevojshme për të bërë ëndrrat tuaja realitet!



Të lumtur dhe të emocionuar, ata morën një taksi për në aeroport dhe blenë dy bileta për në Brazil!



K ishte shumë njerëz interesant në aeroport. Mes gjithë njerëzve të tjerë, ata panë një turist dhe e kuptuan menjëherë se ai ishte me të vërtetë i lumtur: ai mbante një kapele prej kashte dhe syzet e diellit.

Me siguri, ai ishte nisur për në pushimet e ëndrrave të tij, për të cilat ai kishte kursyer për një kohë shumë të gjatë.



F luturimi i tyre kishte numrin... AZ674... dhe ndërsa ata po prisnin të hipnin në avion, ata panë pilotin të hynte në kabinë.

Iris i tha Arkos: «Ai duhet të jetë një person i zgjuar, ai është pothuajse i ngjashëm me atë burrin e raftit të tretë majtas, që ndodhet në krahun e djathtë në Muze.»

Fluturimi ishte një përvojë e mrekullueshme! Qielli ishte i pafundëm dhe para se të ngjiteshin mbi re, ata madje panë edhe një ylber. Retë poshtë dukeshin si malet e pambukut dhe kur ata panë oqeanin, ai ishte po aq i pafund sa qielli!



Pastaj, aeroplani filloi të zbresë: ata ishin tashmë shumë pranë destinacionit të tyre. Arko dhe Irisi zbarkuan ekzaktësisht në kohë në aeroportin Antonio Carlos Jobim, në Rio de Zhaneiro.

Jashtë aeroportit, ata takuan një zonjë që shiste fruta. Ajo ishte veshur në mënyrë pak të çuditshme, por, për të thënë të vërtetën, ata deri tani kishin parë e njihnin vetëm kutitë e parave në Muze. Kur pa se ata dukeshin pak si të përhumbur, gruaja ofroi t'i shoqëronte për pak kohë. Arko i tha Irisit: «Ky duhet të jetë një vend vërtet i bukur, thjesht shiko sa të mirë dhe të sjellshëm qe janë njerëzit.» Duke qenë se zonja dukej qe ishte një biznesmene e vërtetë, Irisi kërkoi ndihmën e saj dhe i kërkoi disa këshilla, pasi ata nuk ishin marrë kurrë me para të vërteta më parë e nuk dinin shumë mbi to.



10



Zonja i këshilloi që të bënin një plan: pra të vendosnin se për sa kohë e sa gjatë do të udhëtonin dhe të llogaritnin se sa para mund të shpenzonin çdo ditë për ushqim, akomodim dhe udhëtim. Nëse ata mund të arrinin të kursenin diçka çdo ditë, atëherë mund të blinin edhe disa suvenire për miqtë e tyre në muze. Ajo gjithashtu u sugjeroi që ata të mbanin gjithmonë edhe disa para veç, sepse nuk i dihej asnjëherë se çfarë të papriturash mund të ndodhnin, pasi ishin larg shtëpisë. Siç thotë fjala e vjetër: gjithmonë duhet kursyer diçka për ditët e këqija. Irisi pohoi me kokë dhe tha se pikërisht këtë gjë do të bënin.


Dhe na doli që Arko dhe Iris ishin administratorë të shkëlqyer të parave të tyre: për të kursyer atë pak që kishin, shpesh u duhej të flinin në tendë dhe pranonin edhe ftesat e mikpritjes për të kaluar një natë në kasollet e disa prej njerëzve që takuan në vendet që vizitonin. Ata biseduan me këta njerëz dhe kështu mësuuan zakone të reja dhe kjo ishte një mënyrë për t'u pranuar si pjesë e këtyre banorëve! Falë parave që ata kishin kursyer duke vepruar në këtë mënyrë, Arko dhe Iris ia dolën që të vazhdonin pushimet e tyre, madje blenë biletat e trenit për në Kili për të parë pinguinët mbretërorë, deri në kufijtë e Amerikës së Jugut.

Gjatë kthimit, ata madje bënë punë me kohë të pjesshme që u mundësuan kështu edhe një zbritje të çmimit të biletës në anijen që shkonte për në Peru.



Në Peru, ata ndoqën këshillën e një banori vendas e me shumë pak para, blenë dy bileta autobusi i cili, pas një udhëtimi në një rrugë gjarpëroshe nëpër Luginën Urubamba, i solli ata në Machu Picchu, në qytetin antik të Inkasve. Ata u futën në botën e mrekullueshme të së kaluarës dhe të arkeologjisë! Zbuluan se inkasit përdornin guackat Spondilus edhe si një mjet për të paguar. Në ato kohë ato kishin vlerë si ari.

Për fat të keq, pushimeve po u afronte fundi....
...çfarë vendesh të mrekullueshme kishin parë falë përkujdesjes për paratë e tyre duke kursyer dhe sa argëtuese kishte qenë kjo aventurë!!!! Çdo ditë kishte qenë shumë emocionuese, ndryshe nga qendrimi brenda kutive të xhamit në Muze!!!



14

15

Iris i tha Arkos: «Ndihej shumë mirë, sepse kemi mësuar disa gjëra të rëndësishme në këtë udhëtim... Unë nuk e kisha menduar kurrë se po të vendosnim objektivat që donim të arrinim, kjo do të na ndihmonte t'i realizonim dëshirat tona. Në fakt, duke ditur qartë se çfarë duam të bëjmë, ne kurrë nuk harrojmë planin tonë dhe ne gjithmonë mund të zgjedhim që edhe të ndryshojmë mendje për gjërat, siç bëmë kur vendosëm të shkonim në Kili.» Më pas Arko shtoi: «Duke mos e shpërdoruar paratë tonë, kemi arritur të shikojmë shumë më tepër vende nga sa kishim ëndërruar dhe u argëtua shumë!»

Tani kishte ardhur koha për t'u kthyer në Muze.
Në fluturimin për në shtëpi, ata u ulën pranë
një vajze të re që ishte rreth moshës së tyre.
Ajo kishte një çantë plot me monedha.
Vajza ishte shumë e zënë duke i numëruar një
për një monedhat dhe gjatë kësaj kohe nuk i
vuri re fare Arkon dhe Irisin.



16

Më pas, ajo ngriti sytë dhe u prezantua me
shumë mirësjellje: «Unë jam Peni kursimtarja,
në fakt, unë vetëm kursej aq sa mundem. Unë jam
duke u kthyer nga pushimet dhe këto monedha janë
paratë që kanë mbetur. Unë do i ruaj ato që të mund
të shkoj të takoj gjyshërit e mi verën që vjen.» Arko e
pyeti nëse ajo i dinte rregullat e duhura për
administrimin e parave. Ajo u përgjigj: «Më pëlqen
të kursej, jo sepse unë jam dorështrenguar, por
sepse kam shumë dëshira të cilat dua që t'i realizoj.»

N dërsa Peni po fliste, ajo i vendoste monedhat që po numëronte në një kuti me pamje të çuditshme. Duke parë kuriozitetin e tyre, Peni u tregoi atyre kutinë, një kuti e vogël me ndarje të shumta të veçanta, dhe shpjegoi: «Më mësuan prindërit kur isha shumë e re për të qenë e pavarur dhe për të planifikuar mirë, në mënyrë që të realizoj ëndrrat e mia. Më ndihmon kutia e parave që më dhanë që të zgjedh se si t'i përdor paratë që më jepen ose edhe mund t'i mbledh ato pasi bëj ndonjë punë të vogël nëpër shtëpi.



Për momentin, kam vendosur që dua të heq disa para mënjane për Krishtlindje, për ditëlindje dhe për pushimet e mia, si këto që sapo bëra. Por unë e di që ka njerëz që janë shumë më pak me fat se unë, ndaj mbaj diçka më vete edhe për këta njerëz, sepse më pëlqen të jap!»

Arko dhe Iris ishin vërtet shumë të lumtur kur mbërritën në Torino. Në udhëtimin e tyre ata kishin vizituar vende interesante, kishin takuar njerëz të rinj dhe kishin mësuar vërtet shumë gjëra të reja!

Ata e kuptuan se mund të bëjnë edhe shumë udhëtime të tjera, mund të takojnë plot miq të rinj të kulturave e vendeve të ndryshme, të cilët flasin gjuhë tjetër, dhe mund të shohin edhe kafshët ekzotike... por së pari ata duhet të kursejnë paratë e nevojshme për të realizuar gjithë këto dëshira!



Ata kishin frikë se mund të harronin gjithçka që kishin mësuar, kështu që Iri i tha Arkos: «Ne duhet të shkruajmë një poezi, e cila do të na ndihmojë të kujtojmë çdo gjë të rëndësishme që kaluam.»



Vjersha e milingonës së duruar

*Unë kam shumë ëndrra në kokën time,
dhe shtoj nga një ëndërr çdo natë kur jam në shtrat.
E di që nuk mund të realizohen të gjitha,
Dhe unë duhet t'i mendoj ëndrrat prapë.
Nëse jam e duruar dhe e kujdesshme,
Kutia ime e parave do të mbushet plot.
Duke kursyer gjithmonë një thërrime sot,
Dhe një copë bar një ditë tjetër,
Kam jetuar në dimrat shumë të ftohtë.
Nëse kursej një qindarkë në ditë siç më thanë,
Ndoshta mund t'i shndërroj të gjitha në ar!
Të gjithë e dinë se nuk është kaq e vështirë:
Me kujdes e me durim mund të realizoni
çdo dëshirë!*



MUZEU I KURSIMIT

Muzeu i Kursimit është një zonë unike dhe inovative e krijuar për të inkurajuar edukimin financiar. Shumë njerëz kanë vështirësi në menaxhimin e aseteve të tyre për shkak të mungesës së aftësive bazë ekonomike dhe financiare. Muzeu synon të ndihmojë njerëzit të marrin vendime në mënyrë racionale dhe nëpërmjet informimit mundëson që ata të arrijnë qëllimet e tyre prioritare. Në dhomat e muzeut, fëmijë, adoleshentë dhe të rritur ndjekin një rrugëtim të veçantë që i ndihmon ata të reflektojnë mbi përdorimin e ndërgjegjshëm të parave dhe u mëson mbi financat nëpërmjet përjetimeve të një shumëllojshmërie mënyrash multimediatike.



Museum of Saving

Via San Francesco d'Assisi 8/a

Toll-free number (from Italy): 800 167 619

info@museodelrisparmio.it

www.museodelrisparmio.it

From 10 a.m. to 7 p.m. - Closed on Tuesday

Reservations required for groups and schools

Follow the Museum of Saving on:

 @museodelrisparmio

 @MdR_Torino

 @mdr_torino



KUTIA E PARAVE

- 1 **Fëmijët me Ylber**, 1970–1980, enë balte të forta të emaluara, Tajvan
- 2 **Globe Albie & Gibie Vultures Wonderful Airlines**, 1990, qeramike, SHBA
- 3 **Plaka në një kolltuk**, 1960–1970, allçi, prejardhje e panjohur
- 4 **Shoqëria Misionare Metodiste Globe**, 1970, plastike, MB
- 5 **Globi**, 1930–1940, llamarina, Itali
- 6 **Valixhe Trip Money**, 1990, qeramike, MB
- 7 **Taksi**, 1980–1990, plastike, Greqi
- 8 **Turist**, 990–2000, porcelani, MB
- 9 **Pilot aeroplani**, 1954, plastikë, SHBA
- 10 **Gruaja braziliane**, 1990–2000, papier mâché, Brazil
- 11 **Kasolle me fëmijë**, 1950, qeramike me xham, Itali
- 12 **Vagon-Lits**, fundi i viteve 1800, llamarina, Belgjikë
- 13 **Transatlantic**, 1930–1940, qeramike, Francë
- 14 **Minibus**, 2000, letër mâché, Peru
- 15 **Burri me mustaqe**, 1960–1970, i kthyer dhe i lyer me terrakotë ftohtë, pelushi, Meksikë
- 16 **Penny Kursimtarja**, 1950–1960, porcelan, MB
- 17 **Kuti e kuqe me katër ndarje**, 1930, kallaj, MB
- 18 **Vajza e vogël kineze**, 1990–2000, enë balte pikturuar fort në të ftohtë, Kinë
- 19 **Elefanti me majmun**, fillimi i viteve 1900, zamak, Itali
- 20 **Fëmija Polic**, 1990, enë balte lyer me të ftohtë, Francë
- 21 **Derri Javanez**, 1600–1800, terrakota, Indonezi
- 22 **Vajza e vogël holandeze**, 1960–1970, porcelani, Holandë

Përkthyer nga Intesa Sanpaolo Bank Albania

Graphic design
Mosaico Studio

MdR
MUSEO DEL RISPARMIO

Conoscere, capire, sperimentare.



www.museodelrisparmio.it